



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

**BURSA PËR KURSIN VEROR TË ENERGJISË NË BAKU TË  
AZERBAJXHANIT**

Qendra “Caspian” për Energjinë dhe Mjedisin e Universitetit ADA në Baku të Azerbajxhanit në partneritet me SOCAR dhe British Petroleum, organizon **“Shkollën Verore të 13-të të Energjisë në Baku”** në datat 6-20 korrik 2019. Në organizimin e shkollës verore do të kontribuojnë edhe drejtuesit e kompanive të tjera si: TAP, Total, Statoil, Exxon, Petronas, përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Energjetikës, Ekologjisë, Burimeve Natyrore të Azerbajxhanit dhe SOFAZ, ekspertët më të njohur nga qendrat shkencore të tilla si: Universiteti i Oksfordit, Universiteti Princeton dhe Akademia Ruse e Shkencave etj.

Programi dy javor në Baku synon të bashkojë studiues me famë botërore, akademikë dhe hartuesit e politikave për të diskutuar mbi çështje të energjisë globale dhe mjedisit si dhe për zbatimin e tyre në praktikë. Kursi do t’i pajisë pjesëmarrësit me njohuritë e nevojshme për energjinë, mjedisin, ekonominë, gjeopolitikën e energjisë, ligjin e energjisë dhe menaxhimin strategjik. Në një fokus të veçantë të programit përfshihen edhe tema për zhvillimin rajonal të rrjetit të tubacionit, gjeopolitikës dhe statusit të saj ligjor, si dhe një përshkrim strategjik i SOCAR-it.

Nënvizojmë se për bursat e ofruara për kursin e verës në Azerbajxhan duhet të aplikojnë kryesisht profesionistë nga kompanitë energjetike, politikëbërësit, nëpunësit civilë nga institucionet qeveritare dhe organizatat ndërkombëtare, gazetarët si dhe studentë të diplomuar që kanë si fokus në hulumtimin e tyre çështjet e energjisë dhe mjedisit.

Tarifa e shkollimit për Shkollën Verore të Energjisë është 2500 EURO. Tarifa përfshin materialet mësimore, transportin lokal, aktivitetet jashtëshkollore, drekën dhe udhëtime në terren. Gjithashtu, pjesëmarrësit duhet të mbulojnë vetë shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit.

Afati i fundit për aplikimin online është data **1 maj 2019.**

Për më shumë informacion rreth programit të kursit dhe kriterëve të aplikimit referojuni adresave në faqen e website:

[http://ccee.ada.edu.az/apply-now/;](http://ccee.ada.edu.az/apply-now/)

[http://ccee.ada.edu.az/bses-baku-summer-energy-school/;](http://ccee.ada.edu.az/bses-baku-summer-energy-school/)

[http://ccee.ada.edu.az/;](http://ccee.ada.edu.az/)

e-mail: [summerschool@ada.edu.az](mailto:summerschool@ada.edu.az)

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE  
ASISTENCËS**